



Datë: 15.07.2025
Numër Protokolli: 4742/2025

A.nr.910/2025

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës–Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosijen e Ankesave në përbërje nga: Eshref Shabani, kryetar, Malsore Gashi Bajraktari dhe Ardita Haxhnikaj Demi, anëtarë, me Sabile Avdyli, në cilësinë e procesmbajtëses, në procedurës sipas ankesës me numër A.nr.910/2025, të datës 19.05.2025, të parashtruar nga ankuesja Q.M-J, kundër organit të punësimit: Ministria e Drejtësisë, në çështjen juridike “*kontestim konkursi*”, duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1, nenin 16 paragrafi 3, dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.2 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr.08/L-180 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosijes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim, me datë 15.07.2025 mori këtë;

V E N D I M

I. Refuzohet si e pa bazuar ankesa me numër A.nr.910/2025, e datë 19.05.2025, e parashtruar nga ankuesja Q.M-J, dhe mbetet në fuqi Njoftimi i datës 23.04.2025 i publikuar nga Njësia për Menagjimin e Burimeve Njerëzore në Ministrinë e Drejtësisë lidhur me anulimin e konkursit RM00016751.

II. Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës duhet të njoftohet me shkrim pas ndërmarrjes së veprimeve në pajtim me këtë vendim.

A r s y e t i m

Kandidatja për pranim në shërbimin civil Q.M-J (*tutje referuar ankuesja*), më datë 19.05.2025, ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, kundër njoftimit për anulimin e konkursit nga NJMBNJ në Ministrinë e Drejtësisë i datës 23.04.2025 lidhur me pozitën “Udhëheqës i Divizionit për Komunikim Strategjik me Publikun” në Zyrën e Sekretarit të Përgjithshëm, ankuesja në ankesën e saj pretendon se komisioni në intervistimin verbal nuk më ka vlerësuar me qëllim me pikë të mjaftueshme dhe kërkon nga KPMSHCK që të aprovoj ankesën dhe të detyroj MD që ta përzgjedh ankuesen.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës (*në tekstin e mëtejme referuar: Këshilli*) bazuar në dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosijes së Ankesave, me datë 29.05.2025, ka proceduar kërkesën për përgjigje në ankesë tek Ministria e Drejtësisë (*tutje MD*), ndërsa, kjo e fundit, më datë 10.06.2025, ka përcjellë përgjigjen në ankesë se bashku me shkresat e bashkangjitura të lëndës.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, administroi këto prova: Ankesën e datës 19.05.2025 e parashtruar nga ankuesi në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Përgjigje në ankesë nga organi i punësimit bashkë me shkresat e lëndës me nr.prot 910/2025 e datës 10.06.2025; Konkursi; Lista e aplikantëve; Njoftimi I datës 19.03.2025; Njoftim për anulim të konkursit e datës 23.04.2025; Njoftimin e datës 07.04.2025; Njoftimin e datës 19.03.2025.

Kolegji i Këshillit duke u bazuar në vlerësimin e hollësishëm të çdo prove veç e veç dhe të gjitha provave të marra së bashku, si dhe bazuar në rezultatin tërësor të shqyrtimit administrativ, ka gjetur se ankesa e parashtruar nga ankuesja është pjesërisht e pa bazuar, **sepse:**

Nga administrimi i shkresave të lëndës rezulton se MD, fillimisht më datë 14.02.2024 ka shpallur konkursin me Nr. Reference RN00016751 për pozitën Udhëheqës i Divizionit për Komunikim Strategjik me Publikun në Zyrën e Sekretarit të Përgjithshëm me afat aplikimi nga data 15.02.2025 deri 16.02.2025

Sipas shkresave të lëndës në këtë procedurë kanë aplikuar 20 kandidatë ku 8 prej tyre kane kaluar fazën e verifikimit paraprak, ndërsa me datë 25.03.2025 kandidatë janë njoftuar se testimi me shkrim do të mbahet me datë 27.03.2025, më tutje pas vlerësimit të testimit me shkrim dhe esesë, vetëm ankuesja ka kaluar në fazën e më tejme do të thotë në intervistimin verbal e cila caktohet të mbahet me datë 22.04.2025.

Tutje sipas shkresave të lëndës rezulton së në këtë konkurs kanë aplikuar ankuesja e cila është përfshirë në listën e verifikimit paraprak, mirëpo sipas Njoftimit të datës 19.04.2025 të Njesisë së Burimeve Njerëzore të MD rezulton se ky proces përfundon pa kandidat fitues, sepse e vetmja kandidate që ka fituar të drejtën për intervistim verbal nuk ka arritur pikët e mjaftueshme për të kaluar pragun prej 70% që të llogaritet si kandidate fituese.

Andaj Kolegji i Këshillit, lidhur me bazueshmerinë e pretendimeve ankimore iu referuar dispozitave të Ligjit Nr. 08/L-197 për Zyrtarët Publikë, gjegjësisht:

- **Nenit 39 paragrafi 1:** *1. Pranimi në shërbimin civil bëhet në të gjitha kategoritë e shërbimit civil, nëpërmjet një procedure rekrutuese të hapur dhe publike, përveç kur parashikohet ndryshe me këtë ligj.*

- **Nenit 44 :** *1. Pranimi në pozitë të kategorisë së ulët dhe të mesme drejtuese bëhet me konkurs të hapur dhe publik të organizuar për çdo pozitë të lirë. 2. Procedura e rekrutimit organizohet nga njësia përgjegjëse për institucionet e administratës shtetërore dhe nga NjMBNj për çdo institucion tjetër shtetëror. 3. Shpallja e procedurës së rekrutimit bëhet nga njësia përgjegjëse, në SIMBNj-së, në ueb faqen e institucionit përkatës, si dhe me mjete të tjera të përshtatshme të informimit. 4. Pranimi i aplikacioneve bëhet brenda tridhjetë (30) ditëve nga data e shpalljes së procedurës së rekrutimit. 5. Konkurrimi zhvillohet në dy (2) faza: 5.1. verifikimi paraprak, përmes së cilit verifikohet nëse kandidatet/ët plotësojnë kriteret e përgjithshme dhe ato të posaçme, sipas shpalljes së konkursit; dhe 5.2. vlerësimi profesional, që përfshin vlerësimin e njohurive, aftësive dhe cilësive profesionale të kandidateve/ëve. 6. Verifikimi paraprak kryhet nga njësia përgjegjëse, ndërsa vlerësimi profesional kryhet nga komisioni i pranimit për pozita të kategorisë së ulët dhe të mesme drejtuese. 7. Vlerësimi profesional i kandidateve/ëve përfshin testim me shkrim në formë elektronike ku sigurohet anonimiteti i konkurrentëve, si dhe intervistë me gojë. 8. Totali i pikëve të vlerësimit të kandidatëve është njëqind (100) pikë. 9. Në përfundim të vlerësimit, kandidatja/i i vlerësuar me më së shumti pikë, por jo më pak se shtatë dhjetë për qind (70 %) të pikëve totale të vlerësimit, konsiderohet kandidat fitues. Të gjithë kandidatet/ët njoftohen individualisht me rezultatet e procesit të rekrutimit. Lista e kandidateve/ëve që*

kanë kaluar pragun prej shtatëdhjetë për qind (70%) të pikëve totale publikohet në SIMBNj-së, si dhe në ueb faqen e institucionit përkatës.

Gjithashtu Kolegji ju referua edhe Rregullores Nr.15/2023 për Pranim në Shërbimin Civil të Kosovës gjegjësisht nenit 10 paragrafit 1, 2, 3, 4 ku përcaktohet se “ 1. *Pas vlerësimit të testimit me shkrim, vlerësimi i kandidatëve vazhdon me intervistën, e cila realizohet në mënyrë verbale e cila duhet të përfundojë më së voni pesëmbëdhjete (15) ditë pas publikimit të listës së kandidatëve që kanë kaluar testimin me shkrim.* 2. *Vetëm kandidatët që kanë marrë të paktën pesëdhjetë (50) pikë në testimin me shkrim, kanë të drejtë të marrin pjesë në intervistë.* 3. *Komisioni i Pranimit njofton kandidatët që kanë kaluar me sukses testimin me shkrim lidhur me ditën, kohën dhe vendin e mbajtjes së intervistës.* 4. *Në intervistë, vlerësohen njohuritë, aftësitë dhe cilësitë e kërkuara që nuk mund të vlerësohen nëpërmjet testimit me shkrim.* Nisur nga ajo që u tha më lartë Kolegji konstaton se është në bindjen e lirë dhe në **diskrecion** të Komisionit të bëjë vlerësimin e pyetjeve të parashtruar kandidatëve në intervistimin verbal, sepse për një gjë të tillë është i mandatuar nga dispozitat e lartëthekësuar në këtë arsyetim të vendimit.

Përmbledhur si më sipër dhe duke u bazuar në nenin 6 paragrafi 1, nën paragrafi 1.1, nenin 18 paragrafi 1 nën paragrafi 1.2 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës i plotësuar dhe i ndryshuar me Ligjin Nr.08/180, Kolegji i Këshillit vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë juridike: Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Kolegjit. Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh, nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda me numër A.nr.910/2025

Sabile Avdyli

Procesmbajtëse

Eshref Shabani

Kryetare e Kolegjit

Vendimi i dërgohet:

- Ankuesit Q.M-J
- Udhëheqësit të Divizionit për Burime Njerëzore në Ministrinë e Drejtësisë; dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së